



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL  
**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA**  
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

**Anr.131/2025**

**PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Kujtim Pasuli kryesuese, Bujar Muzaqi dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK, me seli në Prishtinë, Sokol Haliti dhe Krenar Xhaferi, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 24.01.2025, merr këtë :

### **V E N D I M**

**HEDHET E PASAFATSHME** ankesa Anr.131/2025 i datës 22.01.2025, të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kundër kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK, me seli në Prishtinë, Sokol Haliti dhe Krenar Xhaferi, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

### **A r s y e t i m**

Me datën 22.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, në të cilën pretendohet se kandidatët për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK, Sokol Haliti dhe Krenar Xhaferi, në kundërshtim me legjislacionin zgjedhor kanë vizituar Shkollën Fillore “Halil Alidema”, në Pozheran të Vitisë, me ç’rast edhe janë fotografuar para shkollës me thirrjet dhe mesazhet e qarta elektorale për ta votuar subjektin politik LDK.

Më tutje parashtruesi i ankesës ka theksuar se tutje në fotografi vërehen shenjat identifikuese të subjektit LDK, me “dy gishta”, simbol elektorale i LDK-së dhe po ashtu fotografia (bashkangjitur provë në këtë ankesë) ka në fund slloganin e LDK-së, numrin e listës zgjedhore me të cilën kandidojnë Sokol Haliti dhe Lumir Abdixhiku dhe ky veprim s’ka të bëjë asesi me përrurimin e kësaj shkolle (referuar në një vendim paraprak të PZAP-it), por me fushatë dhe mesazhe të qarta elektorale dhe politike.

Tutje në ankesa është theksuar me këtë veprim janë shkelur dispozitat e nenit 36, paragrafi 1, 2 dhe 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë në të cilin përcaktohet se “1. *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal, ose edhe ndonjë ndërmarrjeje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale, nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje. 2. Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt politik nuk inkurajon ose përfiton nga nëpunësi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik. 3. Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të subjekteve politike në zgjedhje, burime ose resurse të institucioneve apo organeve publike në nivel qendror ose lokal, apo çdo lloj institucioni tjetër publik.”*

Gjithashtu në ankesë është theksuar se kandidati në fjalë dhe subjekti politik LDK kanë cënuar rëndë dispozitat përkatëse ligjore dhe duke u mbështetur në bazën ligjore dhe argumentet e lartcekura, ka kërkuar që masa e sanksionit të vendoset në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Si provë ka bashkangjitur fotografi të datës 19.01.2025 në ankesë.

Më datë 23.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Lidhja Demokratike e Kosovës për ankesën e parashtruar kundër tyre, duke i dërguar kërkesë për përgjigje deri me datë 24.01.2025, në ora 09:00.

Në përgjigjen në ankesë të datës 24.01.2025, të subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës e kundërshtojnë në tërësi ankesën e parashtruar nga LVV dhe atë për faktin se pretendimi i Lëvizjes Vetëvendosje në ankesën A.nr. 131/2025, se Subjekti Politik LDK dhe kandidati për deputet Sokol Haliti, së bashku me kandidatin tjetër për deputet Krenar Xhaferi kanë shkelur dispozitat e nenit 36 të LZP-së, me rastin e bërjes së një fotoje jashtë ambienteve të objektit shkollor, për më tepër është bashkangjitur një foto nga info-plus.tv Pozheran, por e cila nuk paraqet provë fillimisht ngase në rrjetin social të Sokol Halitit postimi i tillë është krejt tjetër dhe këtu shihet teksti i bashkangjitur mund të jetë shkruar nga vetë ankuesi, që paraqet edhe abuzim me të drejtën e ankesës, për më shumë keni provën e bashkangjitur, por për ta vërtetuar se postimi është origjinal, i pandryshuar dhe i pa edituar që, një gjë të tillë mund ta shifni në faqen zyrtare të Sokol Halitit.

Tutje në përgjigje në ankesë ka theksuar se ankesa është e pasafshme, sepse e njëjta është dorëzuar pas 72 orëve dhe kësisoji PZAP duhet ta hudhë si të palejuar ankesën.

Në përgjigje në ankesë ka kërkuar nga PZAP-i, të marrë vendim meritore për rastin në fjalë duke u bazuar në krejt ato që u thanë që ankesa e subjektit LVV të hudhet poshtë si e palejuar, meqë është dorëzuar jashtë afatit.

Paneli pas vlerësimit paraprak të afatshmërisë së ankesës, gjeti se:

**-Ankesa është e pasafshme.**

Paneli, pas shqyrtimit paraprak të ankesës, ka gjetur se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, parashtruar kundër kandidatëve për deputet nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës- LDK, me seli në Prishtinë, Sokol Haliti dhe Krenar Xhaferi, janë parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 39 paragrafi 3 i LZP-së, i cili përcakton se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket shkeljeve të pretenduara të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatët gjatë periudhës së fushatës zgjedhore dhe ditës së zgjedhjeve, mund të paraqes ankesë në PZAP brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe PZAP-i, do të vendos për ankesën brenda shtatëdhjetë e dy (72) orëve nga koha e pranimit të saj, si dhe neni 13, paragrafi 3, nen paragrafi 3.3 i Rregullores Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, i cili përcakton se “PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk përmbush kërkesat e LZP-së dhe kësaj rregullore për shqyrtim, nën paragrafi 3.3. nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor.*

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP, më datë 22.01.2025, ku ka pretenduar se subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) gjegjësisht kandidatët e këtij subjekti politik Sokol Haliti, së bashku me kandidatin tjetër Krenar Xhaferi, kanë vizituar Shkollën Filllore “Halil Alidema” në Pozhoran të Vitisë, me ç ‘rast edhe janë fotografuar para shkollës me thirrjet dhe mesazhet e qarta elektorale për ta votuar subjektin politik LDK, që është në kundërshtim me nenin 34, paragrafi 1.11 të LZP-së, për vizitën me data 19.01.2025.

Megjithatë, ankesa është parashtruar pas afatit ligjor për paraqitjen e ankesës, sipas nenit 39, paragrafi 3 i LZP-së, ku afati për dorëzimin e ankesës është 48 orë nga ndodhja e shkeljes së supozuar, dhe ankesa është dorëzuar më 22.01.2025, ndërkohë vizitat e kandidatëve të këtij subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosova, Sokol Haliti, së bashku me kandidatin tjetër Krenar Xhaferi, kanë vizituar Shkollën Filllore “Halil Alidema” në Pozhoran të Vitisë më 19.01.2025, që do të thotë se ankesa është dorëzuar pas afatit të paraparë ligjor.

Paneli gjeti se i njëjti është ushtruar pas afatit ligjor, dhe nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të nenit 39 paragrafi 3, nenit 115 paragraf 1 i LZP-së, dhe nenit 9 paragrafi 5 nen paragrafi 5.5 të Rregullës 01/2025, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.131/2025 më datën 24.01.2025

**Kryesues i Panelit**

**Kujtim Pasuli**



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimit të këtij vendimi.